



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/1059

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Vedat Poterqoi - Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së OE “Geo & Land Sh.P.K.”, kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Digjitalizimi i të dhënave për Infrastrukturën Publike dhe Ndërtimi i Webgis-it për Komunën e Rahovecit” me nr. të prokurimit: "623-23- 5382-2-2-1", iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Komuna e Rahovecit, më 22.02.2024, mori këtë:

Vendim

1. **Aprovohet**, si pjesërisht e bazuar ankesa e GEO & LAND SH.P.K. me nr. 2023/1059 , e datës 28/12/2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit “DIGJITALIZIMI I TË DHËNAVE PËR INFRASTRUKTURËN PUBLIKE DHE NDËRTIMI I WEBGIS-it PËR KOMUNËN E RAHOVECIT”, me numër të prokurimit 623-23-5382-2-2-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – KUVENDI KOMUNAL - RAHOVECË.

2. **Anulohet** njoftimi për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit “DIGJITALIZIMI I TË DHËNAVE PËR INFRASTRUKTURËN PUBLIKE DHE NDËRTIMI I WEBGIS-it PËR KOMUNËN E RAHOVECIT”, me numër të prokurimit 623-23-5382-2-2-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – KUVENDI KOMUNAL - RAHOVECË. Obligohet AK që të bëjë përmirësimet e nevojshme në dosjen e tenderit sipas arsyetimeve të dhëna nga paneli shqyrtues.

3. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 29/05/2023, Komuna e Rahovecit,, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me “Digjitalizimi i të dhënave për

Infrastrukturën Publike dhe Ndërtimi i Webgis-it për Komunën e Rahovecit”. Ndërsa me datën 20.07.2023 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku ka anuluar aktivitetin e prokurimit.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës shërbim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 124,000.00 €.

Me 18.12.2023, OE “GEO & Land Sh.P.K.”, ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 19.12.2023 Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 28/12/2023, OSHP ka pranuar ankesën nga OE “GEO & Land Sh.P.K.”, me nr. 1059/23 lidhur me aktivitetin “Digjitalizimi i të dhënave për Infrastrukturën Publike dhe Ndërtimi i Webgis-it për Komunën e Rahovecit” me nr. të prokurimit: "623-23- 5382-2-2-1".

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “GEO & Land Sh.P.K.”, janë parashtruar si në vijim:

Sqarim Hyrës : “Ne si OE konsiderojmë që Vendimi për Refuzim të Kërkesës për Ri-shqyrtim i datës 19/12/2023 nga AK është në kundërshtim me rregullativën ligjore ashtu që cënon sigurinë juridike që e jep Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës së bashku me të gjithë Ligjet tjera që bëjnë ndryshim/plotësimin e këtij ligji. AK me dt. 19/12/2023 ka refuzuar Kërkesën për Ri-shqyrtim, por nuk ka ofruar përgjigje për asnjërin nga pretendimet tona ankimore

Pretendimi i parë (I) : “Me datë 15.12.2023 AK ka publikuar “Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues”, ku AK ka marrë vendim të ANULOJ këtë aktivitet të prokurimit, me arsyetimin si ne vijim: Një dispozite në Ligjin e Prokurimit Publik kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit; 43.5 Procedura e prokurimit pas hapjes së ofertave duhet të anulohet për një nga arsytet e mëposhtme: një shkelje e ligjit ka ndodhur ose do të ndodhe dhe nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një ndryshimi; nëse AK gjatë përgatitjes dhe udhëheqjes së procedurës ka përdorur gabimisht opsionin për procedurën përkatëse; Arsyetim : Njoftimi për Kontrate dhe Dosja e Tenderit, e publikuar me datë: 29.05.2023, në sistemin e Prokurimit Elektronik, është publikuar si Procedurë e Hapur - Shërbime, dhe Jo Kontrate Kornize, kurse Përshkrimi i çmimeve i ofruar nga Njësia Kërkuese ishte Çmim për Njësi me poentim, ku ne si AK gjatë përgatitjes dhe udhëheqjes së procedurës kemi përdorur gabimisht opsionin për procedurën përkatëse.

Në vendimin e tij AK është thirrur në Ligjin e Prokurimit Publik, duke cekur nenin 43.5, i cili nuk ekziston fare në LPP. Andaj vendimi është i kundërligjshëm (në kundërshtim me nenin 59.4 dhe neni 62 i LPP). Ne supozojmë se AK ka tentuar të bazohet në nenin 43.5, i cili është pjesë e Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, dhe si i tillë, thotë (citojmë): 43.5 Procedura e prokurimit pas hapjes së ofertave duhet të anulohet për një nga arsyet e mëposhtme: a. asnjë tender nuk është paraqitur brenda afatit të specifikuar; b. asnjëri prej tenderëve të pranuar nuk është i përgjegjshëm; c. numri i OE të përgjegjshëm për kontratë publike kornizë me më shumë se një OE është më pak se 3(tre); d. nuk ka kërkesa për të marrë pjesë, në procedurat e kufizuara ose konkurruese me negociata, që janë paraqitur brenda afatit të specifikuar; e. numri i kandidatëve të kualifikuar në procedurën e kufizuar/ konkurruese me negociata është më pak se 3; f. nuk ka projekte që janë paraqitur brenda afatit të specifikuar; g. asnjë nga projektet e pranuar në konkursin e projektimit nuk janë të përgjegjshëm; h. nëse urdhërohet nga Organi Shqyrtues i Prokurimit; i. një shkellje e ligjit ka ndodhur ose do të ndodhë dhe nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një ndryshimi; j. nëse AK gjatë përgatitjes dhe udhëheqjes së procedurës ka përdorur gabimisht opsionin për procedurën përkatëse dhe i cili gabim me verifikim të KRPP-se është i pariparueshëm; ose k. nëse është paraqitur një gabim teknik në platformën e prokurimit elektronik nga ndonjë situatë e paparashikuar dhe jashtë kontrollit të AK dhe i cili gabim është i pariparueshëm sipas verifikimit dhe konstatimit nga KRPP. Neni 43.5, pika j në të cilën, si duket AK ka tentuar të bazohet, kërkon verifikimin e KRPP. Andaj, në kërkesën për rishqyrtim të datës 18.12.2023 kemi kërkuar që AK të bëjë publik verifikimin e KRPP, në të cilin do të duhej të bazohej vendimi për anulim, mirëpo AK nuk e ka bërë një gjë të tillë. Andaj, bazuar në Rregulloren nr. 001/2022 për Prokurimit Publik, vendimi për anulim të këtij AP është në kundërshtim me nenin 43.5 të kësaj rregullore, sepse asnjëra nga pikat e këtij neni nuk plotësohet në këtë rast.”

Pretendimi i dytë (II): “AK në vendimin për Anulim të dt. 15.12.2023 ka shkelur LPP, neni 62, sepse ka anuluar (përfunduar) këtë aktivitet të prokurimit duke mos vlerësuar tenderët e pranuar. AK ka vepruar në kundërshtim me vendimin e OSHP të 17.11.2023 nr. 546-23, i cili si i tillë ka kërkuar që aktiviteti i prokurimit të kthehet në ri-vlerësim, dhe jo të anulohet. Pjesë e vendimit të OSHP është po ashtu mendimi i ESH i dt. 21.08.2023 , i cili njësor ka pranuar pretendimet tona ankimore në tërësi dhe ka dhënë rekomandim që procedura të rivlerësohet.

Pretendimi i tretë (III): “Me datë 11.12.2023 ne si OE kemi dhënë një Letër Sqarim ndaj AK si kërkesë e tij për informacione shtesë, ndër të tjera kemi nënvizuar se duket qartë që AK ka qëllime tendencioze që këtë aktivitet të prokurimit mos ta vlerësoj drejt në përputhje me LPP dhe dispozitat nënligjore. Ky pretendim u vërtetua në vendimin e AK të datës 15.12.2023 për anulim, për shkak se: 3.1 Fakti se është kontratë publike me çmime fikse dhe jo kontratë publike kornizë është pjesë e pretendimeve tona ankimore të paraqitura në Kërkesën për Rishqyrtim të dt. 25.07.2023, të cilën AK e ka refuzuar. 3.2 Fakti se është kontratë publike me çmime fikse jo kontratë publike kornizë është pjesë e pretendimeve tona ankimore të paraqitura në ankesën e dt. 04.08.2023, dorëzuar në OSHP, dhe si të tilla janë pranuar në tërësi nga OSHP (vendimi nr. 546-23), mirëpo vendimi final është që procedura të ri-vlerësohet dhe jo anulohet siç ka vepruar AK. 3.3 Arsyetimi i paraqitur nga AK se për këtë aktivitet të prokurimit është kontratë publike me çmime fikse dhe jo kontratë publike kornizë nuk paraqet asnjë pengesë të vetme që ky aktivitet i prokurimit të vlerësohet në përputhje me LPP, nenin 59, nenin 60, dhe nenin 61, dhe për kontratë të shpërblehet OE i përgjegjshëm me çmimin më të lirë.”

Duke u referuar pretendimeve si më sipër “GEO & Land Sh.P.K.”., konsideron se Autoriteti Kontraktues ka shkelur nenin Neni 8, 9, 12 dhe 108/A të LPP-Së . Duke kërkuar nga OSHP, si dhe në mbështetje të

plotë në LPP-në dhe legjislacionin sekondar, të nxjerrë këtë: Vendim që të I. Aprovohet, si e bazuar ankesa e OE “Geo&Land” Sh.P.K. II. Anulohet njoftimi i AK - Kuvendi Komunal - Rahovec, i datës 15.12.2023. III. Obligohet AK- Kuvendi Komunal - Rahovec që të bëjë rivlerësimin e tenderit në përputhje të plotë me LPP.

Përgjigja e AK ne ndaj kërkesës për rishqyrtim: “ Autoriteti Kontraktues: Komuna e Rahovecit, me datë: 15.12.2023, me Formularin: B58 - Njoftim mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, te publikuar ne Sistemin e prokurimit elektronik: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>, ju ka Njoftuar se AK anulon aktivitetin e prokurimit, me arsyetim: Një dispozitë në Ligjin e Prokurimit Publik kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit; 43.5 Procedura e prokurimit pas hapjes së ofertave duhet të anulohet për një nga arsytet e mëposhtme: një shkelje e ligjit ka ndodhur ose do të ndodhë dhe nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një ndryshimi; nëse AK gjatë përgatitjes dhe udhëheqjes se procedurës ka përdorur gabimisht opsionin për procedurën përkatëse; Arsyetim: Njoftimi për Kontratë dhe Dosja e Tenderit, e publikuar me datë: 29.05.2023, në sistemin e Prokurimit Elektronik, është publikuar si Procedurë e Hapur – Shërbime, dhe Jo Kontratë Kornizë, kurse Përshkrimi i Çmimeve i ofruar nga Njësia Kërkuese është Çmim për Njësi me poentim, ku ne si AK gjatë përgatitjes dhe udhëheqjes se procedurës kemi përdorur gabimisht opsionin për procedurën përkatëse. Nga konstatimet e lartcekur u vendos si në dispozitave të këtij Vendimi. Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik ne Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.”

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 03.01.2024 ka autorizuar ekspertin për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 1059/23, ndërsa me datë 15.01.2024 është dorëzuar raporti i ekspertit me nr. 2023/1059 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa OE ankues aprovohet si pjesërisht e bazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK Pajtohet rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues, Ndërsa OE nuk Pajtohet rreth rekomandimeve të ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për te vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore ne kuptim te nenit 24 paragrafi 1 te Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin merititor lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE “Geo&Land” Sh.P.K eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2023/1059 ka vlerësuar si në vijim:

Sqarim hyrës: “Ky aktivitet prokurimi është kthyer në rivlerësim me Vendim të OSHP-së, nr. 546/23, pas rivlerësimit AK ka marr vendim për anulim të kësaj procedure dhe OE si palë e pakënaqur me këtë vendim, ka ngritur disa pretendime për të cilat eksperti shqyrtues është përgjigjur si më poshtë.”

Konstatimi i pare (I): “OE ankues pretendon që: “Me datë 15.12.2023 AK ka publikuar “Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues”, ku AK ka marrë vendim të Anuloj këtë aktivitet të prokurimit. Në vendimin e tij AK është thirrur në Ligjin e Prokurimit Publik, duke cekur nenin 43.5, i cili nuk ekziston fare në LPP. Andaj vendimi është i kundërligjshëm (në kundërshtim me nenin 59.4 dhe neni 62 i LPP). Neni 43.5, pika j në të cilën, si duket AK ka tentuar të bazohet, kërkon verifikimin e KRPP. Andaj, në kërkesën për rishqyrtim të datës 18.12.2023 kemi kërkuar që AK të bëjë publik verifikimin e KRPP, në të cilin do të duhej të bazohej vendimi për anulim, mirëpo AK nuk e ka bërë një gjë të tillë. Andaj, bazuar në Rregulloren nr. 001/2022 për Prokurimit Publik, vendimi për anulim të këtij AP është në kundërshtim me nenin 43.5 të kësaj rregullore, sepse asnjëra nga pikat e këtij neni nuk plotësohet në këtë rast.” Eksperti sqaron se edhe në ankesën paraprake të parashtruar nga OE ankues në OSHP, eksperti përmes raportit të tij ka pasqyruar shkeljen e nenit 9 të LPP-së e cila është bërë nga ana e AK-së, në rastin kur AK ka ditur saktë sasinë e rrugëve dhe trotualet që duhet digjitalizuar, ku për të njëjtat edhe vet ka pranuar se këto sasi janë të njohura për AK-në përmes përgjigjeve që kadhënë në kërkesat për rishqyrtim të operatorëve ankues, por që të njëjtat nuk i ka vendosur edhe në paramasë, mirëpo ka zgjedhur të shkoj gabimisht përmes çmimeve të peshuara dhe sasive të papërcaktuara. Në vendimin e marr për anulim, AK është thirrur në nenin 43.5 të Rregullores për Prokurimin Publik, përkatësisht pika i dhe j e saj ku thuhet, citojmë: “i. një shkelje e ligjit ka ndodhur ose do të ndodhë dhe nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një ndryshimi; dhe j. nëse AK gjatë përgatitjes dhe udhëheqjes së procedurës ka përdorur gabimisht opcionin për procedurën përkatëse dhe i cili gabim me verifikim të KRPP-së është i pariparueshëm;”. Shkelja e ligjit ka ndodhur nga ana e AK-së dhe kjo shkelje është pasqyruar edhe në raportin paraprak të ekspertit edhe në vendimin e panelit shqyrtues. Sipas nenit 62 të LPP-së, pika 1.1 e këtij neni thotë se - një shkelje e ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodh në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amandamenti ligjor të kushteve të prokurimit, duke përfshirë edhe rastet ku një dispozitë e këtij ligji kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit. Sipas këtij neni AK ka të drejtë të anuloj procedurën e prokurimit si në rastin konkret, për faktin se siç e kemi cekur, paramasa në këtë aktivitet ka qenë e përpiluar gabimisht qysh në fillim të tij, ndërsa sa i përket thirrjes në pikën j, është e paqartë, për shkak se AK nuk ka publikuar asnjë konfirmim të marr nga ana e KRPP-së. “

Konstatimi i dytë (II): “AK në vendimin për Anulim të dt. 15.12.2023 ka shkelur LPP, neni 62, sepse ka anuluar (përfunduar) këtë aktivitet të prokurimit duke mos vlerësuar tenderët e pranuar. AK ka vepruar në kundërshtim me vendimin e OSHP të 17.11.2023 nr. 546-23, i cili si i tillë ka

kërkuar që aktiviteti i prokurimit të kthehet në ri-vlerësim, dhe jo të anulohet. Pjesë e vendimit të OSHP është po ashtu mendimi i ESH i dt. 21.08.2023 , i cili njësoj ka pranuar pretendimet tona ankimore në tërësi dhe ka dhënë rekomandim që procedura të rivlerësohet.” Sipas Raportit të ekspertit dhe Vendimi i OSHP-së me numër 546/23 është kërkuar që lënda të kthehet në rivlerësim. AK ka pranuar vendimin e OSHP-së duke bërë rivlerësimin e ofertave, gjatë rivlerësimit AK ka vërejtur se për pozicionin 3 të paramasës OE ankues ka ofertuar me çmim të ulët, ku sipas RRPP-së dhe Udhëzuesit janë përmbushur kushtet e çmimit jo normalisht të ulët, ku AK duhet të kërkoj sqarime shtesë nga operatori. AK ka vepruar sipas legjislacionit, duke kërkuar sqarime shtesë dhe sqarimet shtesë janë dorëzuar edhe nga ana e OE ankues por sipas rregullores, këto sqarime pranohen vetëm atëherë kur AK bindet se më të vërtetë këto çmime të ulëta janë të arsyeshme. Edhe pse AK përmes vendimit për anulim nuk e ka cekur këtë arsye, vet anulimi i kësaj procedure tregon se AK si duket nuk është bindur mjaftueshëm me shpjegimin e bërë nga ana OE ankues dhe prandaj ka ardhë deri te marrja e këtij vendimi. Pretendimi që AK nuk ka vepruar sipas vendimit të OSHP-së, konsiderojmë se nuk qëndron për arsye se AK ka bërë rivlerësim të procedurës dhe më pas ka ndryshuar vendim, nga rekomandimi për dhënie të kontratës në anulim të kësaj procedure duke u thirrur në RRPP. Por, që edhe sipas ekspertit AK sipas neni 62 të LPP-së, pika 1.1 është detyruar të anuloj këtë procedurë, për shkak të shkeljes së ndodhur të ligjit të paraqitur edhe me raport dhe vendim paraprak.”

Konstatimi i tretë (III) : “Me datë 11.12.2023 ne si OE kemi dhënë një Letër Sqarim ndaj AK si kërkesë e tij për informacione shtesë, ndër të tjera kemi nënvizuar se duket qartë që AK ka qëllime tendencioze që këtë aktivitet të prokurimit mos ta vlerësoj drejt në përputhje me LPP dhe dispozitat nënligjore. Ky pretendim u vërtetua në vendimin e AK të datës 15.12.2023 për anulim.” Eksperti sqaron se pas kthimit të lëndës në rivlerësim, AK ka dërguar Letër Standarde të kërkesës për informata mbi tenderët jo-normalisht të ulët tek OE ankues, duke marr parasysh se pozicioni përmes të cilës ka kërkuar sqarim për pozicionin e tretë në paramasë, sipas nenit 41 të Rregullores për Prokurimin Publik dhe sipas Udhëzuesit për Prokurimin Publik, përkatësisht neni 11 dhe pika 11.1 e këtij udhëzuesi tregojnë për kushtet të cilat duhet të plotësohen, në mënyrë që një tender të konsiderohet si jo-normalisht i ulët. AK duke u bazuar në këto tre kushte të plotësuar siç e përmendëm edhe më lartë ka bërë kërkesë për sqarim duke kërkuar nga operatori ankues në mënyrë të detajuar të sqaroj se si do të përmbushë pozicionin e tretë të paramasës me çmimin e ofruar. OE ankues është përgjigjur ndaj kësaj kërkesë ku ndër të tjerash thekson se, citim: "me përgjegjësi morale dhe penale deklarojmë se çmimi i ofruar për pozicionin e tretë do të realizohet në tërësi sipas kërkesave të kontratës". Sipas pikës 41.10 të RRPP-së, pas marrjes së sqarimeve nga operatori ekonomik, AK duhet të vendosë nëse sqarimi është i mjaftueshëm dhe do të trajtohet njëjtë me tenderët e tjerë apo nëse sqarimi nuk mjafton do të refuzoj tenderin. AK pas këtij sqarimi të marrë, merr vendim për anulim të procedurës së prokurimit duke u bazuar në arsyetimet të cilat i kemi cekur edhe më lartë në këtë raport. Duke marrë parasysh situatën e krijuar, shkeljet e LPP-së dhe gabimet të cilat AK ka lëshuar gjatë kësaj procedure qysh në fillim, gabime të cilat kanë sjellur paqartësi sa i përket sasive dhe çmimeve që duhej të vendosen në paramasë nga operatorët ekonomik pjesëmarrës, ku edhe pse AK ka ditur saktë sasinë e pozicioneve në paramasë, i njëjti nuk i ka paraqitur ato siç duhet, edhe

mendimi i ekspertit është se në këtë pikë të arritur një situatë e tillë e bënë të vështirë të bëhet një vlerësim real i ofertave ekzistuese, andaj konsiderojmë sipas nenit 62, pika 1.1 e LPP-së, vendimi i AK-së për anulim duhet të mbetet në fuqi. ”

Sipas të thënave më sipër, eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive të pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Geo&Land” Sh.P.K. Argumentimi në raportin e ekspertit është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht në dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e eksperteve mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Geo&Land” Sh.P.K janë pjesërisht të bazuara.

Paneli shqyrtues në këtë rast ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për te vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtrësat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritore lidhur me rastin.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Nga sqarimet e dhëna më sipër, konkludohet se eksperti i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive pretendimet e operatoreve ekonomik ankues. Argumentimi në raportin e ekspertit janë mjaft të detajuar, të kuptueshëm dhe bazuar tërësisht dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet e dhëna mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit dhe dokumentet e tjera, andaj pa nevojë për deklarime shtesë paneli i mbështet konstatimet e ekspertit shqyrtues që ankesa e operatorit ekonomik ankues të aprovohej si pjesërisht e bazuar ndërkaj të mbetet në fuqi vendimi i AK që aktiviteti i prokurimit i cituar si në dispozitiv të këtij vendimi të anulohet në tërësi.

Paneli shqyrtues me tej konstaton se i mbështet qëndrimet e dhëna në raportin e ekspertizës që ky aktivitet i prokurimit nuk është zhvilluar konform dispozitave bazë të LPP-së më saktësisht gjatë rivlerësimit nuk është bërë ekzaminimi, krahasimi dhe vlerësimi i ofertave konform nenit 59 të LPP-së. Andaj, duke ju referuar nenit 62, paragrafi 1, pika 1.1 të LPP, citat: *"1. Autoriteti kontraktues duhet të përfundojë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërin nga arsyet: 1.1. një shkelje e ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodh në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amandamenti ligjor të kushteve të prokurimit, duke përfshirë edhe rastet ku një dispozitë e këtij ligji kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit"*. Paneli shqyrtues vendos që për këtë aktivitet të prokurimit të mbetet në fuqi vendimi i AK për anulim dhe nëse AK ka edhe me tej interes të njëjtin ta ritenderojë.

-Përfundim-

Paneli Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së

ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues
Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendi mi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI KOMUNAL - RAHOVECË**
- **OE - GEO & LAND SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: